



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.360/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi-Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR] me vendbanim në Gjermani, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë e palejuar ankesa ZL.Anr.360/2025, e datës 28.10.2025, e parashtruar nga J [REDAKTUAR] me vendbanim në Gjermani, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet Lokale 2025, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 28.10.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.360/2025, e dërguar me email me datë 26.10.2025, nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Gjermani, paraqitur ndaj KQZ-së, me të cilën pretendon se ka mosrespektim të detyrimeve të verifikimit, transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale, që ka rezultuar në mohimin e drejtës së tij për votë si qytetar jashtë Kosovës. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se me datë 29.08.2025 ka dorëzuar aplikimin për regjistrim dhe nuk ka marrë asnjë njoftim automatik për anulim ndërsa me datë 01.10.2025 ka kontaktuar KQZ-në përmes Viber, por komunikimi sipas tij është bërë pa identifikim të personit përgjegjës, me datë 04.10.2025 ka marrë përgjigje me pretendimin se numri “nuk ekziston” ose “nuk funksionon” dhe me pas nuk është paraqitur asnjë provë teknike, log thirrjesh apo vendim administrativ i nënshkruar, siç kërkohet nga Ligji 05/L-031 (nenet 9 dhe 66). Ankuesi pretendon se veprimet e KQZ-së bien ndesh me: Ligjin 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale (nenet 6,8,14,15), Rregulloren Evropiane DSGVO, PSV dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Për arsye të mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialiteti, në përputhje me LZP si dhe Rregulloren Evropiane DSGVO, ankuesi thekson se nuk do paraqes aktualisht emra apo të dhëna të personave të tretë pa pëlqimin e tyre përveç nëse kërkohen zyrtarisht nga PZAP ose me vendim gjykatë.

Andaj, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që të urdhëroj KQZ-në brenda 5 ditëve të dorëzoj logjet teknike, header-at e email-eve, kopjen e vendimit administrativ dhe emrat e zyrtarëve përgjegjës, të konstatojë se mosrespektimi i procedurave ka shkaktuar shkelje të të dhënave personale dhe si pasojë mohim të së drejtës për votë, të marrë masa disiplinore ose kompensuese në përputhje me nenin 82 të DSGVO. Në mungesë të përgjigjes brenda 5 ditëve punë, ankuesi shton se do t'i drejtohem Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) dhe Autoritetit Gjerman për Mbrojtjen e të Dhënave (BfDI). Ankuesi ka bashkangjitur fotografi të bisedave telefonike në Viber, email e dërguar nga KQZ, kërkesën për sqarim përmes email nga KQZ dhe përgjigjen e tyre si dhe dëftesën e regjistrimit si votues jashtë Kosovës.

Në përgjigjen në ankesë, KQZ-ja njofton se afati i ankesave ka përfunduar me datën 5 Shtator 2025, ndërsa KQZ ka certifikuar listën votuese brenda dhe jashtë Kosovës me datën 6 Shtator 2025. Tutje, KQZ sqaron se shtetasi [REDAKTUAR] ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi votues ka shqyrtuar aplikimin dhe pas aprovimit të kërkesës, aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit të kërkesës për regjistrim. Tutje shtojnë se duke u bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve jashtë Kosovës pika 2.7, është kryer verifikimi i votuesve të regjistruar. Për këtë qëllim, KQZ ka kontaktuar numrin e telefonit që ka dhënë aplikuesi gjatë aplikimit, në tentimin e parë në datë 29 gusht 2025 lidhja nuk ka funksionuar dhe me pas janë kryer edhe dy tentativa të tjera në ditë të ndryshme me datë 30 dhe 31 Gusht 2025, por numri i telefonit nuk ka funksionuar prapë. Bazuar në procedurën e lartcekur, kërkesa që fillimisht ishte aprovuar është anuluar me arsyetimin se gjatë aplikimit është dhënë numër telefoni jofunksional, pas pranimi të ankesës nga z.Spahiu, KQZ thekson se ne kemi provuar disa herë të kontaktojmë përsëri në numrin e dhënë në datë 3 Tetor 2025 mirëpo numri ka qenë jashtë funksionit/nuk ekziston.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar.

Me Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, neni 98 paragrafi 1 përcakton se KQZ e njofton secilin aplikues jashtë Kosovës nëse aplikimi është aprovuar apo refuzuar, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni thekson se çdo aplikues te cilit i është refuzuar regjistrimi ka te drejtë në kundërshtim administrative ndaj njoftimit brenda KQZ-së. KQZ themelon një komision brenda institucionit i cili do të shqyrtoj kundërshtimin administrativ të parashtruar kundër njoftimit, ndërsa për rastet e refuzimit KQZ nxjerr vendim. Ndërsa paragrafi 3 i këtij neni përcakton se çdo aplikues te cilit i është refuzuar kundërshtimi administrativ ka te drejtë ankesë në PZAP brenda 48 orëve, nga pranimi i vendimit.

Andaj bazuar në neni 97 dhe 98 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme është sqaruar procedura e aplikimit për votuesit jashtë Kosovës dhe procedurat e konfirmimit dhe procesit të ankesave.

Me këtë rast pala ankuese meqenëse se është anuluar procesi i regjistrimit si votues jashtë Kosovës, i njëjti është dashur që të ushtroj kundërshtim administrativ në Komisionin e themeluar brenda KQZ-së edhe pse vete ankuesi ka pohuar se me dt.04.10.2025 është njoftuar nga KQZ se numri nuk ekziston ose nuk funksionon. Me këtë rast pala ankuese nuk e ka

shfrytëzuar këtë të drejtë për kundërshtim administrativ siç parashihet me nenin 98 parag 2, mirëpo tani më me dt. 28.10 2025 ju është drejtuar me ankesë PZAP-it.

Paneli e hedh si te palejuar ankesën per faktin se PZAP-i vendos vetëm për ankesat ne rastet kur kërkesa e palës refuzohet me vendim te KQZ-së ashtu siç parash nenin 98 parag 3 LZP. Për me tej, Paneli vlerëson se nga përgjigja e KQZ-së shihet se KQZ-ja se me datën 6 Tetor 2025 ka çertifikuar listën e votuesve brenda dhe jashtë Kosovës, ndërsa ankuesi nuk ka dëshmuar me prova se ka ushtruar mjetet juridike te ankimit ashtu siç parashihet sipas dispozita të lartcekur të LZP.

Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesave PZAP nuk i ka shqyrtuar, sepse fillimisht ankesa ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pasafatshme, Paneli e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje e ankesave dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk mund të shqyrtohen dhe ekzaminohen meqenëse ne këtë faze, pasi qe aspekti i afatshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohe.

Ndërsa rreth pretendimeve per shkelje të rendë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 06/L-082, neni 41 neni 28), për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 1 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se “Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, ndërsa *PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.*” Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9 dhe parag, 5 të këtij neni, të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me te cilin është përcaktuar “*Personi fizik ose juridik i cili ka interes ligjor mund të parashtrojë ankesë në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtat e të cilit janë shkelur sipas dispozitave të LZP-së ose rregullave zgjedhore.*” Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe pretendimeve ankimore te ankuesit nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të parashtrohet ankesë e kësaj natyre.

Rrjedhimisht, parashtrimi i ankesës se ankuesi [REDAKTUAR] kundër KQZ-së, me pretendimin se e njëjta ka bërë shkelje të rendë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 06/L-082, neni 41 neni 28), i cili ndalon qartë publikimin publik të dhënave personale pa pëlqimin e personit të cilit i përkasin ato, nuk hynë në kompetencat e ankesave të cilat mund të parashtrohen në PZAP.

Neni 115 LZP parasheh se, PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore. Paneli vlerëson se ankesa ankuesit për shkak të shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është e palejuar ngase me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme

dhe me Rregullat Zgjedhore, PZAP nuk ka kompetencën për te vendos sanksionim apo marrje te masave tjera ligjore për shkeljet e pretenduar të kësaj natyre.

Prandaj, nga arsyet e theksuar më lartë, si dhe nenit 97, 98, dhe 115 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejueshme.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.360/2025 më datën 29.10.2025

Kryesues i Panelit,
Ramush Bardiqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.